

## **Studime MASTER**

### **Arbitrazhi dhe teknikat tjera alternative për zgjidhjen e konflikteve**

#### **Semestri dimëror 2015/16**

Prof. Dr. iur. Iset Morina LL. M.

Statusi: obligative

Orari i konsultimeve: Pas ligjëratës

Adresa elektronike: [iset.morina@uni-pr.edu](mailto:iset.morina@uni-pr.edu)

#### **Orari i ligjëratave: Sistemi Bllok**

E hënë, 09.11.2015, ora 09.00 – 13.00

E martë, 10.11.2015, ora 09.00 – 13.00

E mërkurë, 11.11.2015, ora 09.00 – 13.00

////////////////////////////////////

E premte, 13.11.2015, ora 09.00 – 13.00

E shtunë, 14.11.2015, ora 09.00 – 13.00

**Salla D1** (mbetet mundësia e ndërrimit të sallës)

#### **Përmbajtja**

- **Sugjerime të përgjithshme**
- **Hyrje në arbitrazhin dhe teknikat tjera alternative për zgjidhjen e kontesteve**
  - Natyra juridike e arbitrazhit
  - Ndërmjetësimi
  - Negociimi
  - Arbitrazhet e njohura në rajon dhe në botë
  - Burimet formale të arbitrazhit
  - Llojet e arbitrazheve
  - Përparësitë dhe të metat e arbitrazhit
  - Marrëveshja lidhur me arbitrazhin
  - Përbërja e tribunalit të arbitrazhit
  - Kompetenca e tribunalit të arbitrazhit
  - Zhvillimi i procedurës së arbitrazhit
  - Përfundimi i procedurës së Arbitrazhit
  - Shpenzimet e procedurës së arbitrazhit
  - Procedura sipas mjeteve të goditjes
  - Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të tribunalit të arbitrazhit
- **Veçoritë e një procedure të arbitrazhit me element ndërkombëtar**
  - Burimet formale
  - Rregullat e brendshme dhe marrëveshjet bilaterale dhe ndërkombëtare

### **Literatura bazë:**

- Brestovci, Faik, E drejta procedurale civile II, Prishtinë 2004
- Morina, Iset, Arbitrazhi dhe procedura e arbitrazhit (botimi parashihet të jetë në Nëntor 2015)

### **Literaturë e rekomanduar:**

- Morina, Iset/Nikqi, Selim, LPK-Komentar, Prishtinë
- USAID, Raport dhe rekomandime për zhvillimin dhe zbatimin e suksesshëm dhe efektiv të sistemit për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve, 30 Prill 2010.

### **Ligjet dhe marrëveshjet ndërkombëtare:**

- Ligji për procedurën kontestimore
- Ligji për arbitrazhin, nr, 02/L-75;
- Ligji mbi zgjidhjen e Kolizionit të Ligjeve
- Konventa e Hagës për procedurën civile të vitit 1954
- Konventa e Hagës lidhur me komunikimin e shkresave të vitit 1965
- Konventa e Nju Jorkut për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit;
- Konventa europiane mbi arbitrazhin tregtar ndërkombëtar
- UNCITRAL Arbitration Rules
- Rregullat e Tribunalit të Arbitrazhit të Odës Ekonomike të Kosovës
  
- *Direktiva e UE (Brukseli I)*
- *Direktiva e UE (Brukseli II A)*

### **Koncepti didaktik**

Metodologjia e ligjërimit do të orientohet në krijimin e mundësive të studentët për të zotëruar dhe fituar njohuritë për Arbitrazhin dhe atë lidhur me Arbitrazhin vendor dhe ndërkombëtar. Ligjërata do të zhvillohet edhe me trajtimin e shumë rasteve praktike për të kuptuar më mirë lëndën.

Për këtë arsye, kërkohet prej studentëve që qysh në ligjëraten e parë të kenë me vete sidomos këto materiale ligjore:

- Ligji për Arbitrazhin
- Rregullat e Tribunalit të Arbitrazhit të Odës Ekonomike të Kosovës

Suksese në Vitin akademik 2015/16!

## Studime MASTER

### E drejta komparative në fushën e së drejtës private

#### Semestri dimëror 2015/16

Prof. Dr. iur. Iset Morina LL. M.

Statusi: obligative

Orari i konsultimeve: Pas ligjëratës

Adresa elektronike: [iset.morina@uni-pr.edu](mailto:iset.morina@uni-pr.edu)

#### Orari i ligjëratave: Sistemi Bllok

E hënë, 16.11.2015, ora 09.00 – 13.00

E martë, 17.11.2015, ora 09.00 – 13.00

E mërkurë, 18.11.2015, ora 09.00 – 13.00

////////////////////////////////////

E premte, 20.11.2015, ora 09.00 – 13.00

E shtunë, 21.11.2015, ora 09.00 – 13.00

**Salla D1** (mbetet mundësia e ndërrimit të sallës)

#### Përmbajtja

1. Nocioni dhe objekti i së drejtës komparative
2. Ngjashmëritë e familjeve të ndryshme juridike lidhur me institutet juridike kryesore
3. Rrethi juridik gjerman
4. Rrethi juridik roman
5. Rrethi juridik anglosakson
6. Bazat themelore të së drejtës civile dhe të drejtës së procedurës civile të disa vendeve të Evropës lindore

#### Literatura:

Fromont, Michel, Sistemet e huaja të mëdha të të drejtës, përkthim në gjuhën shqipe, Tiranë, 2009

Morina, Iset, E drejta komparative në fushën e së drejtës private, Manual/Skriptë, 2010

Zweigert&H.Koetz, Njohuri për të drejtën e krahasuar (parimet themelore), përkthim në gjuhën shqipe nga Marjana Semini, Tiranë 1994.

Zweigert&H.Koetz, An introduction to comparative law, Oxford, 1998

#### Koncepti didaktik

Për të kuptuar dhe për të zhvilluar të drejtën vetanake (përafrimin e legjisllacionit në Evropë), por edhe për zgjidhjen e rasteve me komponentë të së drejtës së jashtme janë të domosdoshme edhe njohuritë në fushën e së drejtës komparative. Ligjërata do të orientohet në njohjen e së drejtës komparative. Në ligjëratë do të transmetohen, duke u bazuar në institute qendrore juridike dhe rasteve praktike, njohuritë themelore për familjet kryesore juridike (rrethi juridik gjerman, roman, anglosakson dhe për rendin juridik të vendeve të lindjes). Familjet të tjera juridike (skandinave, aziatike dhe religjioze) nuk do të trajtohen. Ligjërata do të mbahet në gjuhën shqipe.

Në ligjëratën e parë do të shpërndahen disa raste, të cilat në vazhdim do të trajtohen. Me anë të këtyre rasteve dëshirohet që të trajtohen në aspektin komparativ disa institute qendrore të së drejtës civile dhe sidomos:

- Lidhja e kontratës
- Shpërblimi për shkak të shkaktimit të dëmit
- Përgjegjësia për tjetrin
- Fitimi i pronësisë

Trajtimi i rasteve në aspektin komparativ do të bëhet në bazë të të drejtave përkatëse. **Për këtë arsye, studentët janë të obliguar që të kenë me vete qysh në ligjëratën e parë, sidomos këto materiale ligjore:**

- Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve (LMD)
- Ligjin për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore (LPDS)
- Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi Kontratat për shitjen ndërkombëtare të mallrave (CISG); (Tekstin e kësaj Konvente mund ta gjeni edhe në gjuhën shqipe në “google”)
- Kodi civil i Francës / Code Civil (në google mund ta gjeni në gjuhën origjinale, por edhe angleze)
- Kodi Civil i Zvicrës dhe E drejta e detyrimeve (në google mund ta gjeni në gjuhët origjinale, por edhe angleze)
- Kodi Civil i Gjermanisë / BGB (në google mund ta gjeni në gjuhën origjinale, por edhe angleze)
- Kodi Civil i Austrisë / ABGB (vetëm në gjuhën origjinale, për fat të keq jo edhe në gjuhën angleze); këtë Kod nuk jeni të detyruar patjetër të siguronit.

Shumë suksese në Vitin e Ri Akademik 2015/16!

Prof. Asoc. Dr. iur. Iset Morina LL. M.